

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**  
**OBJEKTI : TERRENET SPORTIVE TE SHKOLLES SHTIQEN**  
**BASHKIA KUKES**

**Projekti tip**

Projekti tip parashikon realizimin e një fushe sporti multifunkionale e cila mund të përdoret për volejball, basketboll si dhe mini futboll. Vendndodhja e kësaj fushe parashikohet pranë shkollës së mesme shtiqen. Qëllimi final do të ishte përdorimi i kësaj strukture sportive jo vetëm nga nxënësit e shkollës por edhe nga komuniteti.

Fusha do të ketë dimensione të rregullta dhe pjesa e shtruar do të jetë 18,0m x 30,0 m, fusha do të jetë e rrethuar dhe e pajisur me impiant ndriçimi për të mundësuar përdorimin e saj edhe gjatë orëve të mbrëmjes. Për realizimin e fushës së lojës multifunkionale duhet të kryhen punimet e mëposhtme:

- Zbankim e gjurmim dheu deri në thellësinë  $h=25\text{cm}$ . Transport i mbeturinave deri në 5km. Rrafshim dhe ngjeshje e tabanit, trajtim me erbicid;
- Realizimi i një muri mbajtës/kufizues beton arme  $20 \times 30\text{cm}$ , armuar me hekur 4F10mm dhe stafa F6mm/80, mbi një shtresë betoni të varfër me lartësi 10cm;
- Realizimi i shtresës së çakëllit me spesor 20cm. Mbushja e boshllëqeve si dhe nivelimi me anë të një shtrese materiali stabilizat me granulometri të imët përfshirë dhe ngjeshjen dhe dhënien e pjerresisë 0.5% sipas projektit;
- Realizimi i plintave beton/arme për fiksimin e shtyllave mbajtëse të rrjetës së volejbollit dhe koshave të basketbollit;
- Realizimin e shtresës së asfaltit dhe binderit me spesor 6-7cm dhe granulometri 0.8/0.1 rulluar dhe niveluar sipas projektit;
- Realizimi i shtresës sipërfaqësore me anë të aplikimit të disa duarve rezinë me ngjyra të ndryshme sipas projektit;
- Realizimi i vijëzimeve të fushës sipas projektit dhe lojrave që do të luhen, basketboll, volejball, kalçeto;
- Realizimi i sistemit të kullimit të ujrave me anë të gjashtë pusetave të lidhura me tub plastik polietileni  $\Phi 110$
- Realizimi i impiantit të ndriçimit përbërë nga katër shtylla hekuri të xinguar me lartësi 7.5m, vendosur mbi plinta beton/arme me përmasa  $1.0 \times 1.0 \times 1.0\text{m}$ , në secilën prej të cilave do të montohen nga dy projektore nga 400ë.
- Realizimi i rrethimit deri në lartësinë 5,50m, pjesa e parë e rrethimit, nga toka deri në lartësinë 2,50m do të realizohet me rrjetë metalike të xinguar dhe plastifikuar 50x50mm ndërsa pjesa tjetër nga 2,50m deri në 5,50m do të realizohet me rrjetë sintetike. Struktura mbajtëse e rrjetës rrethuese do të jetë tub hekuri xingato me diametër 48mm çdo 2.50m dhe lartësi të alternuar 2,50 dhe 5,50m
- Realizimi i vendqendrimit të spektatorëve.
- Realizimi i pajisjeve sportive strukturës së tabelave të basketbollit, shtyllave mbajtëse për rrjetën e volejbollit, portave të futbollit.

## **Shtresa e betonit**

Shtresë betoni RCK 25, me spesor 10cm, slamp S4, pa përdorim aditivësh për rritjen e rrjedhshmërisë së betonit sepse vështirëson nivelimin. Hedhja e betonit është mirë të realizohet me betonpompë për të bërë të mundur shpërndarjen e njëtrajtëshme të betonit në të gjithë sipërfaqen dhe lehtësuar procesin e nivelimit.

Shtresa e betonit duhet të armohet me një rrjetë të elektrosalduar F5mm 20x20cm.

Sipërfaqja e betonit duhet të jetë e niveluar dhe lëmuar dhe të mos ketë plasaritje, pjesë të dëmtuarë, shtresa të shkëputura apo pluhur.

## **Shtresa e finos**

Trajtimi i sipërfaqes me një përzierje lidhësi dhe rërë kuarcore sferoidale në sasi 2/3kg për m<sup>2</sup>. Lidhja e kësaj përzierje me masën e shtresës së betonit realizohet me anë të levigimit me "helikopter".


Mbas procedurës së levigimit duhet të bëhet prerja me freze e kanaleve (xhuntove) të dilatacionit në distance çdo 4m në të dy drejtimet si dhe mbushja e këtyre kanaleve me shirit pvc.

Shtresa izoluese ndaj avullit përbën një element shumë të rëndësishëm për realizimin e fushave mbi solute betoni, sidomos kur realizimi i shtresës përfundimtare bëhet me elementë me ngjitje. Përdorimi i shtresës izoluese prej polietileni apo membranës HDPE bëhet me qëllim eliminimin e fenomenit të osmozit, ngjitjes së lagështisë nga terreni drejt shtresës së betonit. Shtresa izoluese duhet të shtrihet dhe të mbulojë gjithë sipërfaqen ku do të hidhet shtresa e betonit.

## **Shtresa sintetike sportive**

Shtresë sintetike sportive , lloji "Sistemi me shumë shtresa MAPECOAT TNS Cushion Multisport" nga MAPEI SpA, i përbërë nga një përzierje rezinë akrilike sintetike e lidhur me inerte rezistencë të lartë ndaj përdorimit, me mikrokokrriza gome e cila i jep elasticitet shtresës; përhapur me spatull te gomuar në 6 duar (1 mbushës, 3 shtresa gome, 2 shtresa finale me ngjyrë). Trajtimi i kërkuar do të duhet të ndjekë hapat e mëposhtme:

1. Verifikimi i nivelimit te shtresës se betonit dhe pastrim rigoroz paraprak;
2. Aplikimi me spatull metalike ose spatull gome te nje baze mbushese dhe niveluese qe shërben si mbajtëse për shtresa e sipërme (tipi MAPECOAT TNS Grey Base Coat ,MAPEI SpA), mundësisht holluar me 5-15% ujë, 1-2 në duar në një distancë 8-12 orë nga njëra-tjeta;
3. Pasi thahet, aplikohet shtresa me ngjyrë, ( ngjyra e përcaktuar nga projekti), me bazë rezine akrilike dhe mbushëse e holluar ne uje (tipi MAPECOAT TNS Finish 4 MAPEI SpA), që aplikohet me një spatull të gomuar në 2 ose 3 duar, në një distancë prej 8-12 orë nga njëra - tjeta;
4. Realizimi i vijave kufizuese të zonës së lojës me aplikimin e bojës që përmban rrëshirë akrilike e holluar ne ujë(tipi MAPECOAT TNS Line MAPEI SpA).



rezine sintetike

**Mapecoat TNS Finish**

rezine sintetike

**Mapecoat TNS Line**

baze mbushese

**Mapecoat TNS Grey Base Coat**

beton i niveluar

PROJEKTUESI

Ing. Ramadan MUJA